

University of Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Summer 6-2013

POLITIKAT FISKALE NË KOSOVË

Albina Zuka

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Business Commons](#)



Universiteti për Biznes dhe Teknologji
Departamenti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

TEMA:
POLITIKAT FISKALE NË KOSOVË

Albina Zuka
Qershor /2013
Prishtinë



Universiteti për Biznes dhe Teknologji
Departamenti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

Punim Diplome
Viti akademik 2010-2011

Emri dhe mbiemri i studentit

Albina Zuka

POLITIKAT FISKALE NË KOSOVË

Mentori: Prof. Feim Brava

Qershor/2013

Prishtinë

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Në këtë punim është paraqitur tema “Politikat Fiskale në Kosovë”. Në vazhdim kemi paraqitur reformat tatimore në Kosovë pas luftës, si dhe të hyrat buxhetore sa do të rriten për periudhën 2013-2015, të hyrat vendore etj. Për shkak të vështirësive në dy dekadat e fundit, dhe veçmas gjatë periudhës pas konfliktit, Kosova ende ndeshet me sfida të shumta të zhvillimit ekonomik. Kemi shkallën më të lartë të papunësisë në rajon, shifra më të larta të varfërisë dhe shkallën më të ulët të rritjes ekonomike.

Me anë të këtij punimi kam paraqitur politikat të cilat po i zbaton Kosova. Ky studim ka për qëllim që me të hyrat që shteti i nxjerr nga doganat, taksat, TVSH-të, etj., të investoj në shëndetësi në edukim në investime publike për një zhvillim sa më të mirë në Kosovë.

MIRËNJOHJE / FALENDERIME

Falënderoj të gjithë ata persona të cilët kanë punuar, në këtë punim mjaft të rëndësishëm, duke shfrytëzuar potencialin e vet të dijes, shprehjes së lirë argumentuese gjatë punës në përputhje me aftësitë e veta profesionale të zhvillimit të aktivitetit të tyre në lidhje me këtë punim të diplomës. Po ashtu falënderoj profesorin e nderuar Zt. Feim Brava për kohën dhe gatishmërinë që ka treguar gjatë punës, duke qenë gjithmonë i hapur në komunikim për pyetjet dhe përgjigjet, me çka ka rezultuar në punën e suksesshme në lidhje me këtë punim të temës së diplomës.

PËRMBAJTJA

ABSTRAKT.....	2
MIRËNJOHJE / FALENDERIME.....	3
PËRMBAJTJA.....	4
LISTA E FIGURAVE.....	5
LISTA E TABELAVE.....	6
FJALORI I TERMEVE.....	7
1. HYRJE.....	8
2. SHQYRTIMI I LITERATURËS.....	9
2.1 HISTORIKU.....	9
2.2 REFORMAT TATIMORE NË KOSOVËN E PASLUFTËS DHE ‘REZULTATET’ E TYRE.....	11
2.3 QËLLIMI I POLITIKAVE FISKALE.....	12
2.4 RËNDËSIA E POLITIKAVE TATIMORE.....	13
2.5 LLOJET E NORMAVE TATIMORE.....	14
2.6 RUAJTJA E QËNDRUESHMËRISË FISKALE DHE AVANCIMI I MENAXHIMIT TË FINANCAVE PUBLIKE.....	16
3. KORNIZA MAKRO-FISKALE 2013-2015.....	17
3.1 TË HYRAT NGA KUFIRI.....	19
3.2 TË HYRAT VENDORE.....	21
3.3 STRUKTURA E TË HYRAVE TË MBLEDHURA NË VEND.....	22
3.4 BUXHETI DHE LLOJET.....	24
3.5 ANALIZA KUALITATIVE E RREZIQEVE FISKALE PËR PERIUDHËN 2013- 2015.....	25
3.6 NDARJA E SHPENZIMEVE KAPITALE SIPAS SEKTORËVE.....	26
3.7 BURIMET E FINANCIMIT KOMUNAL.....	28
4. DEKLARIMI I PROBLEMIT.....	30
5. METODOLOGJIA.....	31
6. REZULTATET.....	32
7. DISKUTIME DHE PËRFUNDIME.....	33
8. BIBLIOGRAFIA / REFERENCAT.....	35

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Trendi i të hyrave 2010-2015.....	16
Figura 2. Pjesëmarrja e tatimeve kufitare ne gjithsej të hyrat nga kufiri në përqindje.....	18
Figura 4. Ndryshimi në rritjen e të hyrave nga kufiri dhe ndryshimi në rritjen e importeve.....	18
Figura 5. Struktura e të hyrave brenda vendit 2010-2015.....	20
Figura 6. Të hyrat vendore si përqindje e BPV nga viti 2010-2015.....	20

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Përqindja e Pjesëmarrjes së Shpenzimeve Kapitale sipas Sektorëve nëpër vite.....24

Tabela 2. Korniza afatmesme e financimit komunal 2011-2015 ne miliona euro.....27

FJALORI I TERMEVE

TAK - Tatimi në të Ardhura të Korporatave

TAI - Tatimi në të Ardhura Individuale

KASH - Kornizë Afatmesme e Shpenzimeve

BPV - Bruto Produkti Vendor

TVSH - Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

ATK - Administrata Tatimore e Kosovës

MBPZHR - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

1. HYRJE

Ky punim ka për qëllim njohjen e politikave fiskale në Kosovë të cilat po zbatohen, për kundër krizës ekonomike globale. Rritja ekonomike në Kosovë në vitet e fundit ka vazhduar të jetë pozitive. Mirëpo, gjatë vitit 2009 dhe gjysmës së parë të vitit 2010 vlerësohet se kjo rritje ka ardhur pothuajse plotësisht si rrjedhojë e konsumit dhe investimeve të sektorit publik. Duke marrë parasysh këtë dhe sfidat me të cilat përballet ekonomia e Kosovës, konsiderojmë se zhvillimi i sektorit privat duhet të jetë prioritet për shoqërinë kosovare. Problemet e Kosovës së porsaçliruar kërkuar veprime shumëdimensionale të faktorit ndërkombëtar dhe atij vendor. Këto veprime u orientuan në realizimin e fazës emergjente dhe asaj substancionale të rindërtimit dhe në ngritjen e organeve dhe institucioneve të përkohshme të administratës publike në Kosovë. Me qëllim që të lehtësohet shpërndarja e fondeve të donatorëve, por edhe të krijohen parakushtet për vjeljen e taksave vendore, nga shtatori i vitit 1999 filloi procesi i ndërtimit të administratës financiare në territorin e Kosovës. Ngritja e një autoriteti me atributë të Ministrisë së Financave është cilësuar me prioritet të lartë nga ana e UNMIK-ut. Autoriteti Qendror Fiskal po punon për të krijuar një sistem të menaxhimit buxhetor, të aftë për të alimentuar burimet financiare në kohë dhe për të siguruar që këto burime të shpenzohen me transparencë dhe efikasitet.

Autoriteti Qendror Fiskal i krijuar në Kosovë ushtron funksionet themelore të Ministrisë së Financave si janë formulimi i strategjisë së përgjithshme fiskale duke marrë parasysh kushtet makroekonomike dhe ndikimin e politikës fiskale në zhvillimin ekonomik. Autoriteti Qendror Fiskal me krijimin e administratës tatimore ka arritur që ti kyçë kuadrot lokale më shumë se që arritën të bëjnë këtë departamentet e tjera.¹ Kjo është me rëndësi për kyçje të ekspertëve vendas në hartimin e politikave ekonomike në kuadër të administratës së publike. Në periudhën e deritanishme grumbullimi i taksave dhe doganave dhe shpërndarja e mjeteve buxhetore është bërë në mënyrë të centralizuar në nivel të Autoritetit Qendror Fiskal. Komunitetet deri tani përfituan grantet nga autoriteti qendror për mbulimin e shpenzimeve të tyre themelore funksionale.

Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara pas vendosjes së saj në Kosovë u ballafaqua me një pasiguri lidhur me vendosjen e një sistemi juridik adekuat dhe të pranueshëm për situatën e re të pasluftës. Në fillim ishin të pranishme disa dilema lidhur me atë

¹ Burimi: www.Politikat Fiskale në Kosovë.

se cilat ligje do të mbesin në fuqi. Të njëjtat u qartësuan dukshëm me nxjerrjen e rregullores mbi ligjet në fuqi në Kosovë, sipas së cilës të zbatueshme janë ligjet e Kosovës që ishin në fuqi deri më 22 Mars 1989.

Doganat dhe tatimi në shitje

Ndër rregulloret e para të nxjerrura nga përfaqësuesi special i KB për Kosovën është edhe ajo mbi themelimin e doganave dhe shërbimeve tjera gjegjëse në Kosovë. Me këtë rregullore, me rregulloren mbi akcizën dhe rregulloren mbi taksën e shitjes fillon të funksionojë shërbimi doganor dhe pagesa e taksës dhe te akcizës në importimin e mallrave si një ndër segmentet më të rëndësishme të ndërtimit të sistemit fiskal të Kosovës dhe të institucionalizimit dhe konsolidimit të buxhetit të Kosovës. Niveli jo i kënaqshëm i zbatimit të ligjit është identifikuar si një nga sfidat kryesore me të cilin përballlet sektori privat i Kosovës. Pasojat në këtë drejtim radhiten që nga ndikimi i drejtpërdrejtë në zbatimin e kontratave deri tek problemet me evazionin fiskal dhe korrupsionin të cilat krijojnë në konkurrencë jo-fer në treg. Zbatimi i kontratave, të drejtat e pronësisë intelektuale dhe konkurrenca mungesa e një mekanizmi efektiv dhe eficient për të siguruar zbatimin e kontratave pengon zhvillimin e bizneseve në Kosovë në shumë aspekte. Se pari, bizneset pësojnë humbje për shkak të mos përmbushjes së obligimeve kontraktuale nga ana e blerësve ose furnizuesve të tyre.

Kjo gjithashtu ka të ngjarë të jetë njëra nga arsytet pse shitja e mallrave me kredi nga firmat kosovare dhe blerja e inputeve të firmat me kredi janë shumë më të ulëta tek firmat në Kosovë sesa tek ato në ekonomitë tjera në tranzicion, në rajon dhe ato të Evropës dhe Azisë Qendrore në përgjithësi (Banka Botërore, 2010), gjë që vështirëson blerjen e inputeve dhe shitjen e produkteve për këto firma kosovare. Firmat e intervistuar gjithashtu raportojnë se ballafaqohen me konkurrencë shumë të ashpër nga konkurrentët të cilët nuk paguajnë taksë dhe si rezultat janë në gjendje të shesin produktet e tyre me çmime shumë më të ulëta. Në një shënim të lidhur, rritja e kohëve të fundit në shpenzimet qeveritare ka vënë presion në Administratën Tatimore dhe Doganat që ti rrisin të hyrat, dhe bizneset e intervistuar duket të jenë në ankth lidhur me pasojat potenciale që kjo dukuri mund të ketë në biznesin e tyre.²

² Burimi: Politikat Fiskale në Kosovë.

2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

2.1 HISTORIKU

Tatimet janë burimi kryesor i mbledhjes së të hyrave publike me të cilat shteti i plotëson nevojat për infrastrukturën publike dhe mirëqenien e qytetareve pra krijon mjetet për shpenzimet e nevojshme publike, kjo është thujtë e vetmja mënyrë ligjore për te mundësuar funksionimin e shtetit dhe plotësimin e nevojave publike. Është mekanizëm shtetëror përmes se cilit shteti krijon te hyrat buxhetore (publike) dhe përmes shpenzimit te atyre te hyrave u ofron qytetarëve shërbime dhe mallra publike - infrastrukturë publike, edukimin, shëndetësinë, siguri publike, gjyqësinë etj.

Politika fiskale i referohet veprimeve të qeverisë që ndikojnë në shpenzimet e përgjithshme të qeverisë, normat e tatimeve dhe të hyrat e përgjithshme të qeverisë, apo deficitit i buxhetit qeveritar. Qeveria përpigjet t'i gjejë metodat më të mira për financimin e këtyre shpenzimeve dhe hartimin e politikave ekonomike duke inkasuar llojeve të ndryshme të tatimeve si: TVSH, taksat doganore, tatimet në të hyra personale, tatimi në të hyra të korporatave, kontributet për sigurimin social, etj. Tatimi është dhënie në para të cilat shteti i mbledh prej individëve në bazë të sovranitetit të vet, pa kundër shpërblim të drejtpërdrejtë, me qëllim të mbulimit të ngarkimit publik. Tatimi është dhënie e detyrueshme pa kundër shpërblim të drejtpërdrejtë”.

“Tatimet janë dhënie të detyrueshme, të cilat organet juridiko-publike i mbledhin prej subjekteve ekonomike, kurse për këtë nuk japin kundërvlerë drejtpërdrejtë”.³

³ Burimi: Mustafë Hasani

2.2 REFORMAT TATIMORE NË KOSOVËN E PASLUFTËS DHE ‘REZULTATET’ E TYRE

Në vitet e para të pasluftës Kosova është ndeshur me një ndërhyrje tatimore të çakorduar dhe të vrullshme të bazuar kryesisht në përvojat e vendeve të tjera dhe jo në përputhshmëri me gjendjen dhe nevojat reale të Kosovës së pasluftës e cila është dashur që në shumë sektorë të fillojë nga zeroja. Kosovës i janë dashur më shumë se pesë vite për të pritur fillimin e ndërtimit të një politike tatimore për t’ia përshtatur atë gjendjes dhe nevojave vetanake për të mundur gradualisht marrë frymë më lehtë drejt një politike stabile tatimore. Sfidë e menjëhershme e kësaj faze ishte (dhe ende mbetet) niveli i zbatueshmërisë së tatimeve dhe sidomos futja e kësaj politike në interes dhe përputhje me nevojat e ekonomisë dhe sektorëve të ndryshëm të shoqërisë së ekonomia kosovare ka shënuar rritje relativisht të ultë që nga 1999 (megjithatë, duhet pasur në mendje shkallën shumë të lartë të rritjes në vitin e parë të periudhës pas-luftës, edhe pse, nga një bazë shumë e ulët). Edhe pse, gjatë kësaj periudhe, janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm makroekonomik për ringjalljen e ekonomisë Kosovare, ende mbeten shumë sfida. Një tregues i tillë është bilanci i lartë negativ tregtar, i vazhdueshëm që nga fundi i vitit 1999 Kosova është tejte e varur nga importi (importet përbëjnë rreth 50 % të BPV-së)⁴ dhe trendët tregojnë se në një afat të shkurtër është vështirë të priten ndryshime të mëdha vendit tonë.

Përvoja nga bota na sugjeron që nuk është ide e mirë të injorohen dimensionet administrative të reformës tatimore. Tatimpaguesit individual po ashtu edhe bizneset që ndeshen me ligjet tatimore domosdoshmërisht ndjejnë se nuk mjafton vetëm ligji i shkruar tatimor, por fakti se si aktualisht zbatohet ai në praktikë. Politika tatimore e pasluftës në Kosovë ka filluar me sistemin tatimor dhe rregulloret e ligjet e UNMIK-ut, pothuajse që të gjitha të kopjuara nga vendet e tjera si nga vendet në tranzicion po ashtu edhe nga vendet e BE-së, dhe mospërshtatja e këtyre rregulloreve me gjendjen aktuale në Kosovë.

⁴ Burimi: www.Telegraf.com

2.3 QËLLIMI I POLITIKAVE FISKALE

1. Ofrimi i shërbimeve dhe të hyrave publike për qytetaret (edukimi, shëndetësia, siguria publike, mirëqenia sociale, mbrojtja e ambientit, investimet publike).
2. Stabiliteti makroekonomik. (Qeveria herë pas here përdorë mjete të politikave fiskale si politika tatimore dhe shpenzimet publike për te ndikuar ne zbutjen apo eliminimin e destabilitetit ekonomik).
3. Nxitja e rritjes ekonomike. (Duke krijuar politika që ndihmojnë fusha të caktuara ekonomike apo duke ndikuar ne importet apo eksportet e mallrave si dhe metodave tjera fiskale).
4. Rishpërndarja e të hyrave. Sigurim i mbështetjes sociale; nivelin minimal të të hyrave për personat që janë të sëmurë, fizikisht të sfiduar, të vjetër etj.⁵

⁵ Burimi: Ligjerus Mustafë Hasani.

2.4 RËNDËSIA E POLITIKAVE TATIMORE

Ndërtimi i politikave tatimore dhe zbatimi i tyre përmes mbushjes së buxhetit të vendit në Kosovë kanë një rrol të rëndësishëm ekonomik si dhe për mbajtjen dhe zhvillimin e një seri sektorësh të shoqërisë kosovare. Politika Tatimore e një shteti është pjesë e politikës fiskale që lidhet me përcaktimin e llojeve të tatimeve të zbatuara në një vend, nivelet dhe llojet e përqindjeve tatimore për burimet e ndryshme të të ardhurave dhe raportin optimal ndërmjet tatimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta si dhe llojet e masat e lehtësimeve të ndryshme tatimore. Përveç funksionit të sigurimit të të ardhurave buxhetore, politika dhe sistemi tatimor i çdo vendi luan një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë pastaj në zhvillimin e arsimit; kulturës; shëndetësisë; punësimit dhe veçanërisht në rishpërndarjen e të ardhurave në favor të shtresave shoqërore me të ardhura më të ulëta të cilat në vendin tonë janë në një numër të konsiderueshëm. Politika tatimore e një shteti arsyetohet me organizimin e asaj politike tatimore që ndikon në drejtim të mënjanimin të dukurive që bëhen pengesë për ruajtjen e mirëqenies së përgjithshme të shoqërisë. Këto dukuri lidhen me veprimin jo të përkryer të tregut në: mbrojtjen e shtresave të varfra të shoqërisë, krijimin e vendeve të punës, evitimin e monopoleve dhe rritjen e konkurrencës së mirëfilltë, barabarësinë në mes tatimpaguesve e tjera. Sipas koncepteve të ekonomisë së tregut, që varet nga oferta dhe e cila thekson neutralitetin më të madh tatimor të tatimeve në konsum (harxhim) në krahasim me ato në të ardhura, politika tatimore në Kosovë u zhvendos dhe u përqendrua prej tatimeve të drejtpërdrejta në të ardhura, në tatimet jo të drejtpërdrejta në konsum (harxhim). Para së gjithash jo përmes rritjes së normës tatimore të këtyre tatimeve, por përmes zgjerimit të përfshirjes apo bazës tatimore. Sistemi dhe infrastruktura ligjore tatimore është kusht i domosdoshëm për arritjen e qëllimeve fiskale që do të thotë se ligjet e të gjitha llojeve të tatimeve duhet që të jenë të kuptueshme dhe lehtë të interpretueshme si për tatimpaguesit po ashtu edhe për zyrtarët tatimorë që merren me zbatimin e ligjeve tatimore në praktikë. Rëndësia e një politike të mirëfilltë tatimore ka qenë prej shumë kohësh sfidë e qartë për ata që janë të angazhuar me politikën tatimore në vendin tonë. Në praktikë ky shqetësim nuk ka pasur të njëjtën qartësi.⁶

⁶ Burimi: www.Politikat Fiskale në Kosovë.

2.5 LLOJET E NORMAVE TATIMORE

- I. Norma Proporcionale,
- II. Norma Progresive dhe;
- III. Norma Regressive.

Përparësitë dhe të Metat

Norma tatimore proporcionale

Norma proporcionale tatimore caktohet me ligj dhe është e njëjtë për te gjithë dhe pa marre parasysh lartësinë e bazës tatimore. Kështu që me rritjen e të ardhurave, rritet në përpjesëtim të drejtë edhe ngarkesa tatimore, por nuk ndryshon lartësia e normës tatimore

Përparësitë e tatimit proporcional janë:

- I. Është objektiv;
- II. Është i thjeshtë;
- III. Përjashton çdo egoizëm dhe;
- IV. Ngarkon njëjtë të gjithë obliguesit tatimorë.

E metë e normës proporcionale tatimore është se nuk e plotëson parimin e barabarësisë së tatimit dhe të sakrificës së njëjtë.⁷

Te metat e normës progresive

- I. Të tatuarit progresiv shpesh ndikon në mënyrë destimulative në aktivitetin ekonomik të obliguesit tatimor, sepse e nxit mosinteresimin për rezultate më të mëdha në punë, madje edhe e lënë pas dore angazhimin në punë;

⁷ Burimi: Ligjerus Mustafë Hasani.

- II. Norma tatimore progresive duhet patjetër të ndalet në një lartësi të caktuar ashtu që, edhe pse edhe më tutje bëhet rritja e bazës tatimore, nuk bëhet rritja e mëtutjeshme e normës tatimore.

Tatimi progresiv - përparësitë

- I. Të tatuarit progresiv ndikon në realizimin e politikës sociale të shtetit, sepse me aplikimin e normave tatimore progresive zvogëlohen ndryshimet sociale;
- II. Mund të ndikojë edhe në mënyrë stimulative. Dihet se me aplikimin e normës tatimore zvogëlohet fuqia ekonomike e obliguesit tatimor, andaj ajo mund të ndikojë në obliguesin tatimor që të gjejë forma organizative, tekniko-teknologjike për rritjen e aktivitetit dhe zvogëlimin e shpenzimeve, në mënyrë që të realizojë të ardhura më të mëdha.

Norma tatimore regresive

- I. Norma regresive e tatimit është atëherë kur me rritjen e bazës tatimore zvogëlohet norma tatimore;
- II. Në praktikë aplikimi i normës regresive tatimore është rrallësi.⁸

⁸ Burimi: Ligjerus Mustafë Hasani.

2.6 RUAJTJA E QËNDRUESHMËRISË FISKALE DHE AVANCIMI I MENAXHIMIT TË FINANCAVE PUBLIKE

Krahas krijimit të parakushteve për rritje të qëndrueshme ekonomike qeveria e Kosovës në vazhdimësi do të angazhohet për rritjen e efikasitetit të shpenzimeve publike, si dhe për rritjen e vazhdueshme të të hyrave buxhetore. Qeveria e Republikës së Kosovës, synon që brenda mandatit të saj qeverisës të ngris nivelin e të hyrave buxhetore në mbi 1.6 miliard euro deri në fund të vitit 2014 me një rritje prej mbi 40 % krahasuar me vitin 2010, në të njëjtën kohë do të zhvillojë politika fiskale të cilat nuk do të rëndojnë zgjerimin e biznesit në Kosovë. Në funksion të realizimit të këtyre objektivave fiskale Qeveria e Kosovës, mbetet e përkushtuar në implementimin e një sërë masash me qëllim të rritjes së të hyrave buxhetore dhe uljes së evazionit fiskal, siç janë;

- I. Fiskalizimi i plotë i të gjitha bizneseve funksionale deri në fund të mandatit qeverisës;
- II. Implementimi i plotë i strategjisë për luftimin e ekonomisë jo-formale;
- III. Kthimi i kontrollit në pikat kufitare 1 dhe 31;
- IV. Instalimi i sistemeve të reja informative në Administratën Tatimore të Kosovës dhe në Doganat e Kosovës të cilat do të mundësojnë kontrollin më të saktë të mallrave dhe transaksioneve financiare.

Krahas masave për rritje të vazhdueshme të të hyrave buxhetore, qeveria e Kosovës është e përkushtuar të përmirësoj efikasitetin e shpenzimeve publike. Në këtë kontekst Qeveria garanton fuqizimin e mëtutjeshëm të rolit të kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH) si dokument kryesor planifikues buxhetor, i cili në mes tjerash ka për qëllim të përmirësoj ndërlidhjen e planifikimit të politikave dhe të alokimit të resurseve buxhetore, dhe në të njëjtën kohë të ofrojë një transparencë më të madhe gjatë procesit buxhetor.⁹

⁹ Burimi: Ministria e Financave.

3. KORNIZA MAKRO-FISKALE 2013-2015

Korniza afatmesme makro-fiskale e cila paraqet bazë për përpilimin e kornizës së shpenzimeve 2013-2015 është përgatitur duke marrë për bazë të gjitha politikat të cilat janë duke u implementuar në vazhdimësi si dhe supozimet për politika të reja, të inkorporuara edhe në kornizën makro-fiskale mbi të cilën është ndërtuar buxheti i vitit 2012. Zhvillimet e fundit ekonomike të shoqëruara me implementimin e politikave të orientuara drejt rritjes së qëndrueshme ekonomike dhe reformave strukturore japin indikacione për një rritje mesatare relativisht të lartë ekonomike përgjatë kësaj periudhe e cila parashihet të arrijë në rreth 5 %.

Sidoqoftë, një rritje e tillë mund të jetë më e lartë dhe të arrijë normën prej 6-7 % me realizimin e projekteve të mëdha infrastrukturore dhe turistike, respektivisht me fillimin e projekteve siç janë Rruga 6, Brezovica dhe Termocentrali Kosova e Re, përfshirë këtu edhe pjesëmarrjen e sektorit privat. Ekonomia e Kosovës vazhdon të varet nga importet që kryesisht financohen nga dërgesat prej diasporës dhe donatorëve.

Përkundër rritjes së vazhdueshme të eksporteve gjatë viteve 2010-2012, baza e ulët e eksporteve e shoqëruar me rritje të nivelit të importeve (si rezultat i implementimit të projekteve të mëdha kapitale e shoqëruar me rritje të çmimeve) ka rezultuar në rritjen e deficitit tregtar i cili edhe paraqet sfidë me të cilën ballafaqohet ekonomia e Kosovës. Në mungesë të instrumenteve të politikës monetare, tkurrja e deficitit tregtar mund të arrihet vetëm përmes ndryshimit të çmimeve relative e që nënkupton zvogëlimin e kostos së prodhimit vendor në raport me çmimet e importit. Andaj, me qëllim të arritjes së një rritje të qëndrueshme ekonomike, mbajtja e normës së inflacionit të kostos së prodhimit vendor në shkallë më të ulët se kostoja e produkteve të importuara e shoqëruar me ngritje të cilësisë, është esenciale për një periudhë afatgjate.¹⁰

Të hyrat e përgjithshme buxhetore, për periudhën 2013-2015, planifikohen të rriten me një mesatare vjetore prej 2.7 % për të arritur vlerën prej € 1, 499 milionë në vitin 2015. Kjo shifër përfaqëson rritje prej 8.3 % në të hyrat e përgjithshme në raport me të hyrat e buxhetuara për vitin 2012. Gjatë vitit 2013, të hyrat e përgjithshme buxhetore priten të rriten me një normë prej rreth 2.0 % në raport me vitin 2012. Kjo përfaqëson ngritjen më të ngadalshme përgjatë periudhës raportuese kryesisht si rezultat i të hyrave më të vogla të njehershme, përderisa të hyrat

¹⁰ Ministria e Financave, Korniza Afatmesme.

tatimore parashihet të rriten me rreth 4.5 %. Përderisa, gjatë vitit 2014 dhe vitit 2015 të hyrat e përgjithshme planifikohen të rriten me një normë vjetore prej 4.1 % respektivisht 2.1 %.

Si kontribuues kryesor në të hyrat e përgjithshme janë të hyrat tatimore, të cilat përfshijnë të hyrat nga tatimet në kufi dhe të hyrat nga tatimet brenda vendit. Këto të hyra deri në fund të vitit 2015 pritet të arrijnë shumën prej € 1,305 milionë, duke shënuar një rritje prej rreth 15.8 % krahasuar me vitin 2012. Të hyrat jo tatimore, të cilat përfshijnë të hyrat vetanake nga niveli qendror dhe ai komunal si dhe taksat koncesionare, planifikohen të arrijnë në € 193 milionë në vitin 2015 duke shënuar rritje prej 11% në raport me vitin 2012. Kategorizimi i këtyre të hyrave si pjesëmarrje në BPV, tregon se të hyrat e përgjithshme si pjesëmarrje në BPV përgjatë viteve 2012-2015 pritet të shënojnë rënie mesatare prej 1.1 %. Të hyrat tatimore dhe ato jo-tatimore gjithashtu pritet të shënojnë rënie (më të lehtë) në mesatare prej 0.2 %.¹¹

¹¹ Ministria e Financave.

3.1 TË HYRAT NGA KUFIRI

Të hyrat nga kufiri si burim kryesor i të hyrave totale buxhetore marrin pjesë në të hyrat totale mesatarisht me 65 %. Në fund të periudhës raportuese (2015) të hyrat nga kufiri planifikohen të arrijnë në € 991 milionë, shifër e cila përfaqëson rritje prej 13.3 % në raport me të hyrat e planifikuara nga kufiri për vitin 2012. Ky nivel i parashikuar i rritjes së të hyrave nga kufirit për periudhën raportuese kryesisht vjen si rezultat i supozimit të rritjes së nivelit të importit¹².

Rritja e të hyrave nga kufiri përcjellë trendin e njëjtë të rritjes së importit, që do të thotë së përgjatë viteve, në përgjithësi, rritja e importit u përcjellë me rritje të të hyrave. Bazuar në këto të dhëna, është e arsyeshme të besohet se një trend i ngjashëm do të përcjellët edhe në vitet vijuese.


Për më shumë, parashikimet për të hyrat nga kufiri marrin parasysh edhe projeksionet për trendin e çmimeve gjatë kësaj periudhe. Kontribut pozitiv në rritjen e të hyrave nga kufiri pritet të jep edhe ngritja e vazhdueshme e performancës së Doganave të Kosovës përmes ngritjes së bashkëpunimit me doganat në rajon dhe më gjerë, vlerësimit të bazës doganore, avancimit të analizave të riskut, avancimit të sistemit informativ si dhe luftimit të informalitetit.

Po ashtu, rol të rëndësishëm në rritjen e të hyrave pritet të jep edhe futja nën kontroll e pikave kufitare 1 dhe 31. Në grafikun është e paraqitur pjesëmarrja e tatimeve specifike në gjithsej të hyrat nga kufiri. Kontribuues kryesor në të hyrat nga kufiri janë të hyrat nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) me një pjesëmarrje prej mesatarisht 50 %, pasuar nga tatimi mbi akcizë (35 % përderisa pjesëmarrje taksave doganore në gjithsejtë të hyra nga kufiri është 15 %). Gjatë kësaj periudhë nuk parashihen ndryshime substanciale në normat aktuale tatimore andaj edhe struktura e të hyrave pritet të mbetet e njëjtë.

¹²Burimi: Ministria e Financave.


Grafiku 8: Trendi i të hyrave 2010-2015

Grafiku 9: Ndryshimi në rritjen e të hyrave nga kufiri dhe ndryshimi në rritjen e impoeteve




Burimi: MF, Departamenti i Markoekonomisë

Grafiku 10: Pjesëmarrja e tatimeve kufitare në gjithsej të hyrat nga kufiri, në %



Burimi: MF, Departamenti i Thesarit dhe kalkulimet e departamentit të makroekonomisë

Grafiku 8: Trendi i të hyrave 2010 - 2015



Burimi: MF, Departamenti i Thesarit dhe kalkulimet e departamentit të makroekonomisë

13

¹³. Burimi: Fig. 8 Departamenti i Thesarit dhe kalkulimet e departamentit të makroekonomisë. Fig. 9 Departamenti i makroekonomisë dhe Fig. 10 Departamenti i Thesarit dhe kalkulimet e departamentit të makroekonomisë.

3.2 TË HYRAT VENDORE

Të hyrat nga tatimet vendore përfaqësojnë kontribuuesin e dytë më të madh në të hyrat totale, me një pjesëmarrje në mesatare prej 22 % për periudhën 2013-2015. Të hyrat vendore në fund të vitit 2015 planifikohen të arrijnë në € 352 milionë, shifër e cila përfaqëson ngritje prej 22.4 % në raport me të hyrat e buxhetuara për vitin 2012. Gjatë vitit 2012, të hyrat vendore planifikohen të ngritën me 10.2 % në krahasim me vitin 2011, përderisa gjatë vitit 2013 rritja në të hyrat vendore planifikohet të shënoj 6.1 %. Ndërsa, rritja vjetore gjatë vitit 2014 dhe 2015 planifikohet të jetë 5.4 % dhe 9.5 % respektivisht.

Parashikimet për ngritjen në të hyra nga tatimet vendore, bazohen në rritjen e aktivitetit afarist në vend i cili vjen si rezultat i rritjes së përgjithshme ekonomike si dhe në angazhimet e vazhdueshme për ngritjen e efikasitetit përbrenda Administratës Tatimore të Kosovës.


Administrata Tatimore e Kosovës tashmë ka aprovuar Strategjinë e Përbushjes e cila përqendrohet në segmentimin e tatimpaguesve në përgjithësi, mirëpo fokus të veçantë iu kushton tatimpaguesve të cilët nuk i përmbushin detyrimet tatimore. Angazhimet e ATK-së, gjatë periudhës së strategjisë, do të fokusohen në zgjerimin e bazës tatimore dhe ngritjen e mbledhjes së tatimeve. Në këtë kontekst, ky institucion ka zhvilluar një pako aktivitete të cilat janë në funksion të rritjes së të hyrave dhe uljes së evazionit fiskal. Këtu përfshihen lëshimi i numrave fiskal, ku gjatë vitit të kaluar është bërë pajisja e të gjitha bizneseve funksionale me këta numra dhe pajisja e bizneseve me arka fiskale, aktivitet ky i cili pritet të zhvillohet edhe gjatë vitit 2012 e tutje. Po ashtu, hapa tjerë kanë të bëjnë me vlerësimin e stoqeve të kompanive, kontrollet më të shpeshta, si dhe avancimin e sistemit informativ (SIGTAS). Për më shumë, funksionalizimi i njësisë mbi hetimet tatimore, e-deklarimi dhe funksionalizimi i qendrës së thirrjeve pritet të jap kontributin e vetë, në drejtim të rritjes së të hyrave.¹⁴

¹⁴ Burimi: Korniza makro-fiskale Ministria e Financave.


3.3 STRUKTURA E TË HYRAVE TË MBLEDHURA NË VEND

Të hyrat e mbledhura nga TVSH-ja vendore vlerësohet të kenë pjesëmarrjen më të madhe në të hyrat e përgjithshme vendore gjatë periudhës projektuese. Të hyrat nga tatimi në të ardhurat personale projektohen të jenë kontribuuesi i dytë në gjithsej të hyrat nga tatimet vendore me një rritje mesatare vjetore prej 8.2 %. Të hyrat nga tatimi në të ardhurat e korporatave përgjatë periudhës raportuese (2013-2015) projektohen të shënojnë rritje mesatare vjetore prej 8.4 % Të hyrat vendore si pjesëmarrje në BPV në vazhdimësi kanë shënuar ngritje, dhe parashikimet për vitin 2012 flasin për ngritje të vazhdueshme. Në fund të vitit 2015 pjesëmarrja e të hyrave vendore në BPV planifikohet të arrijë në 6 %

Grafiku 11: Struktura e të hyrave brenda vendit



Grafiku 12: Të hyrat vendore si % e BPV



15

Përkundër faktit se ulja e tatimit TAK në 10 % edhe pse e mirë ishte e pafajshme në dhënien e ndonjë rezultati konkret investitiv, ngritja e TVSH-së, mendoj unë se nuk pati ndonjë ndryshim për të mirë pozitiv në të kundërtën ajo shkaktoi goditje të lehtë në çmimet e mallrave për tregun

¹⁵ Burimi: Fig. 11 Departamenti i thesarit dhe kalkulimet e departamentit të makroekonomisë. Fig. 12 Departamenti i thesarit dhe kalkulimet e departamentit të makroekonomisë.

kosovar. Ajo vetëm se ka shkaktuar ngritjen e çmimeve në tregun e Kosovës. Politika tatimore apo zbatimi i mirë i sistemit tatimor nuk matet me vetëm nëse administrata përgjegjëse mbledh apo jo më shumë të ardhura, por matet me lehtësimin e procedurave për tatimpaguesit dhe veçanërisht për investitorët e huaj në mënyrë që t'iu bëhet sa më atraktiv dhe jo burokratik tregu në Kosovë. E gjithë kjo e bënë politikën tatimore apo administratën tatimore një çështje komplekse. Rezultati i arkëtimit të të hyrave gjatë një viti kalendarik mund të mos jetë gjithnjë baza më e përshtatshme për vlerësimin e punës së administratës tatimore. Por, mënyra se si është bërë qasja për rritjen e të ardhurave; efekti i përpjekjeve për gjenerimin e të ardhurave; krijimi i një klime tatimore për barazinë në mes të tatimpaguesve; rritja e "pasurisë" politike të qeverisë dhe niveli i mirëqenies ekonomike mund të jenë të barabarta me faktin se sa janë rritur më tepër të ardhurat. Shpenzimet publike të krijuara nga institucionet dhe të hyrat nga administrata tatimore dhe doganat si institucione që merren me zbatimin e politikës tatimore, duhet të merren në konsideratë dhe vëmendje e nevojshme duhet t'i kushtohet faktit se cila e ardhur apo lloj i tatimeve duhet të jetë objekt i masave shtrënguese. Tatime të thjeshta apo lehtë të zbatueshme në praktikë si përvojë që vjen nga vende të ndryshme me përvojë në politikën tatimore është domosdoshmëri e një sistemi tatimor të thjeshtë, në mënyrë që të sigurojë se do të ketë kuptueshmëri për tatimpaguesit, dhe rritjen e një numri sa më të madh prej tyre që ofrojnë t'i paguajnë detyrimet tatimore në mënyrë vullnetare, pa pasur nevojë të ketë sanksionime apo dënime shtesë siç parashihen me ligj.¹⁶

Në procesin e formulimit të politikës tatimore dhe reformave tatimore, politikbërësit përcaktojnë objektivat të cilat synojnë t'i realizojnë dhe instrumentet me të cilat ato objektiva bëhen të realizueshme, duke iu përmbajtur detyrimisht principeve të menaxhimit fiskal siç janë: transparenca lidhur me objektivat, implementimin e politikës tatimore dhe publikimin e llogarive publike, stabiliteti i procesit të bërjes së politikës tatimore, efikasiteti i ndikimit të politikës tatimore në ekonomi, përgjegjësia në menaxhimin e financave publike, efikasiteti i modelimit dhe implementimit të politikës tatimore etj. Për realizimin e këtyre objektivave vitin e fundit në politikën tatimore të Kosovës në vazhdimësi ka pasur reforma, pas pajisjes së tatimpaguesve me numrat fiskal, hyrjen në fuqi të pakos ligjore për TVSH dhe TAK dhe pajisja e bizneseve me arka fiskale.

¹⁶ Burimi: Ministria e financave.

3.4 BUXHETI DHE LLOJET

Buxheti paraqet pasqyrimin e të ardhurave të planifikuara dhe shpenzimet e shtetit, buxheti i shtetit është një akt me të cilin vlerësohen të ardhurat dhe të hyrat, si dhe përcaktohen shpenzimet dhe të daluarat për një vit, në pajtim me legjislacionin në fuqi. Buxheti përbëhet nga pjesa e përgjithshëm edhe ajo e veçantë.¹⁷

Buxheti mund të përcillet edhe përmes

Suficiti buxhetor

- Shpenzimet buxhetore janë më të vogla se të hyrat buxhetore.

Deficiti buxhetor

- Shpenzimet buxhetore janë më të mëdha se të hyrat buxhetore.

Buxheti i ekuilibruar

- Shpenzimet buxhetore janë të barabarta me të hyrat buxhetore.

Qëllimi ekonomik i buxhetit është:

- Ndarja në mes të konsumit privat dhe atij shoqëror;
- Ndikon në ofertën e faktorëve të prodhimit (puna, kapitali);
- Realizimi i qëllimeve makroekonomike.¹⁸

¹⁷ Burimi: Politikat Fiskale.

¹⁸ Burimi: Politikat Fiskale.

3.5 ANALIZA KUALITATIVE E RREZIQEVE FISKALE PËR PERIUDHËN 2013-2015

Rreziqet e ndërlidhura me realizimin e të hyrave të projektuara

Korniza fiskale 2013-2015, parasheh që të hyrat e përgjithshme buxhetore të rriten nga € 1,411 milionë në vitin 2013, në € 1,499 milionë në vitin 2015. Ngritja e nivelit të të hyrave përgjatë periudhës së projektuar do jetë më graduale në krahasim me ngritjen e parashikuar të të hyrave nga viti 2010-2012 (rreth 16.7 %).

Vlerësimi i potencialit në realizimin e të hyrave për periudhën 2013-2015 duhet bazuar në analizën e rrezikut për mbledhjen e të hyrave të parashikuara gjatë vitit 2012, si dhe me ambientin makroekonomik në periudhën afatmesme 2013-2015. Parashikimet që përcjellin realizimin e të hyrave shtesë përgjatë kësaj periudhe, kanë të bëjnë me: përshtatshmërinë e ambientit makroekonomik, si atij të brendshëm ashtu edhe atij të jashtëm, si dhe me suksesin e institucioneve gjegjëse për ngritjen e performancës në arkëtimin e të hyrave.

Rreziku sistematik (apo makroekonomik) - në përgjithësi, rreziku makroekonomik vlerësohet të jetë i ulët. Ambienti i jashtëm makroekonomik nuk parashihet të përcjellët me rreziqe të larta, duke vazhduar me rimëkëmbjen e ngadalshme pas krizës së theksuar të borxheve që u shënuan gjatë vitit 2011 dhe me pasojat që pritet të vazhdojnë edhe gjatë vitit 2012.

Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bruto Prodhimi Vendor në nivel global gjatë vitit 2013 pritet të shënoj ngritje prej 3.9 %, pas rishikimit të vlerësimit mbi rritjen ekonomike gjatë vitit 2012 e cila vlerësohet të jetë 3.3 %. Në të njëjtën kohë, rritja e çmimeve si në nivel të shteteve të zhvilluara po ashtu edhe në nivel të shteteve në zhvillim pritet të ngadalësohet duke u përcjellë me një normë mesatare vjetore të inflacionit gjatë vitit 2013 prej 1.3 % respektivisht 5.5 %.¹⁹

¹⁹ Ministria e Financave.

3.6 NDARJA E SHPENZIMEVE KAPITALE SIPAS SEKTORËVE

Pjesëmarrja e shpenzimeve kapitale në buxhetin e Kosovës tregon në përgjithësi misionin e secilit sektor. Në këtë kuptim është normale që në sektorin e zhvillimit ekonomik pjesëmarrja e shpenzimeve kapitale të jetë shumë e lartë përderisa në sektorin e arsimit dhe kulturës apo në sektorin e shëndetësisë dhe mirëqenies nuk është një pjesëmarrje kaq e lartë. Kjo për arsye se sektorët e ndryshëm mbulojnë edhe funksione të ndryshme publike. Në terma nominalë, totali i shpenzimeve kapitale pritet të rritet nga niveli i vitit 2012 prej € 492.2 milionë euro në € 537.6 milionë deri në vitin 2015.

Zhvillimi Ekonomik / Infrastruktura

Rreth tri të katërtave të shpenzimeve kapitale të qeverisë janë të ndara për këtë sektor. Kjo rrjedhë si pasojë që brenda këtij sektori kryesisht janë organizatat buxhetore si Ministria e Infrastrukturës, përgjegjëse për rrugët e vendit dhe autostradat, Ministria e Zhvillimit Ekonomik që ka përgjegjësinë për infrastrukturën e Ndërmarrjeve Publike, MBPZHR që mbulon sektorin e zhvillimit rural dhe shumica e rregullatorëve që rregullojnë sektorin ekonomik. Pjesëmarrja e shpenzimeve kapitale të këtij sektori në totalin e shpenzimeve kapitale për vitin 2012 ishte 73 %, ose nga € 492.2 milionë për këtë sektorë ishin të ndara në shpenzime kapitale € 357,3 milionë. Deri në vitin 2015 kjo përqindje pritet të rritet në 76 %. Në terma nominalë, shuma e shpenzimeve kapitale për këtë sektor deri në vitin 2015 do të jetë € 410.8 milionë.²⁰

²⁰ Burimi: Ministria e Financave -Korniza Makro Fiskale.

Arsimi dhe Kultura

Pjesëmarrja e këtij sektori si të shpenzimet e përgjithshme ashtu edhe në shpenzimet kapitale për periudhën e planifikuar pritet të ketë një rënie të lehtë gjatë periudhës së planifikimit, duke u zvogëluar nga 8% në 2012 deri në 6% në vitin 2015. Kjo është për shkak të ngadalësimit të ndërtimit të shkollave nga qeveria qendrore dhe politikës së ndarjes së fondeve për mjete të konkretizimit, përmirësimit të mësimdhënies dhe mirëmbajtjes së objekteve. Megjithatë, shuma nominale e shpenzimeve kapitale në këtë sektor do të jetë € 34.8 milionë në vitin 2015.

Shëndetësia dhe Mirëqenia

Pjesa më e madhe e shpenzimeve në këtë sektor janë për transferet sociale dhe shërbimet shëndetësore, prandaj ky sektor nuk ka ndonjë pjesëmarrje të lartë në shpenzimet kapitale të qeverisë. Në vitin 2012 pjesëmarrja e këtij sektori në totalin e shpenzimeve kapitale të qeverisë ishte 4 % dhe deri në vitin 2015 kjo përqindje pritet të jetë afërsisht e njëjtë. Shpenzimet nominale, pritet të rritet pak nga € 21.9 milionë në € 23.8 milionë gjatë të njëjtës periudhë.

Rendi dhe Siguria Publike

Në mënyrë të ngjashme, pjesëmarrja e shpenzimeve kapitale për këtë sektor nuk paraqet përqindje të madhe në buxhetin kapital të përgjithshëm. Gjatë gjithë periudhës së planifikimit, ata pritet të qëndrojnë në nivele konstante me një rënie prej 1% ndërmjet vitit 2012 dhe 2015, ose nga 8 % - 7 %. Në terma nominalë shuma e shpenzuar në këtë sektor parashikohet të bjerë nga € 40.1 milionë në € 35.6 milionë euro gjatë kësaj periudhe. Duhet theksuar se në buxhetin e vitit 2012 është ndarë një shumë prej rreth € 5-5.5 milionë për shpenzime të njehershme.²¹

²¹ Burimi: Korniza Makro Fiskale. www.Ministria e Financave.

3.7 BURIMET E FINANCIMIT KOMUNAL

Financimi komunal përfshinë: të hyrat vetanake të komunës, grantet specifike operative, grantet për kompetencat e shtuara, transferet për kompetencat e deleguara, grantet e jashtëzakonshme, ndihmat financiare nga jashtë. Ndërsa, aspekti i huamarrjes së komunave do të jetë si opsion i ri i mundshëm i financimit që është paraparë në ligjin përkatës, i cili do të jetë në dispozicion të komunave vetëm në kuadër të kushteve strikte të përcaktuara me ligj dhe pas aprovimit të Ministrisë të Financave.

Të gjitha të hyrat nga burimet në vijim janë të hyra vetanake të komunës: tatimi në pronë, taksat komunale, gjobat, tarifatat dhe pagesat në pajtim me autoritetin që u është dhënë komunave me LFPL.

Komunat pranojnë grante operative nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe ato janë: Granti i përgjithshëm, Granti specifik për arsim dhe Granti specifik për shëndetësi, përfshirë financimin për shëndetësi sekondare. Grantet bazohen në kritere të drejta, transparente dhe objektive, duke ju dhënë kështu komunave pavarësi më të madhe në alokimin dhe shpenzimin e tyre. Komunat, gjithashtu pranojnë nga niveli qendror financimin për transferet e kompetencave të shtuara dhe të deleguara.²²

²² Burimi: Ministria e Financave.

Tabela: Korniza afatmesme e financimit komunal 2011-2015, mil euro

Përshkrimi	2011 Aktuale	2012 Aktuale	2013 Buxheti	2014 Parashikimi	2015 Parashikimi
1. Grantet qeveritare	295.90	298.83	309.92	312.19	312.34
Granti i përgjithshëm	114.20	118.70	128.30	129.90	130.05
Granti specifik për shëndetësi	38.20	39.83	40.43	41.10	41.10
Granti specifik për arsim	143.50	140.30	141.19	141.19	141.19
Financimi bazë	142.85	139.09	140.32	140.32	140.32
Politikat në vazhdim :	0.65	1.21	0.87	0.87	0.87
Qendrat e ekselencës	0.04	0.43	0.87	0.87	0.87
Gjuha angleze	0.46	0.78	0.00		
Pedagogët	0.15		0.00	0.00	0.00
2. Grantet për kompetencat e shtuara	2.85	2.60	2.60	0.00	0.00
Kujdesi shëndetësor dytësor	2.85	2.60	2.60	0.00	0.00
3. Të hyrat vetanake komunale	51.88	60.00	63.00	64.00	65.00
4. Financimi kontingjent për decent.	1.50	-	-	-	-
MAPL (komunat e reja)	1.50				
5. TOTAL FINANCIMI KOMUNAL	352.13	361.43	375.52	376.19	377.34

23

²³ Burimi: Financimi Komunal agregat 2013-2015.Ministria e Financave.

4. DEKLARIMI I PROBLEMIT

Detyra e parë që do të duhej ta bënte Qeveria e Kosovës për të pasur zhvillim ekonomik është të stimulohet prodhuesi vendor në mënyrë që të rritet prodhimtaria dhe produktet që vinë nga shtete e ndryshme të botës në Kosovë të zëvendësoheshin më ato vendore. Prodhimtaria e Kosovës po zhvillohet shumë ngadalë dhe problem janë politikat për investime në sektorin e prodhimit, që gjatë gjithë kësaj kohe nuk kanë mundur të jenë më konkurrense sesa në vendet e tjera. Politikat fiskale nuk janë aspak në shërbim të zhvillimit ekonomik në vend. Kamatat e larta bankare po e rrezikojnë edhe në tej këtë zhvillim. Ndërtimi i politikave tatimore dhe zbatimi i tyre përmes mbushjes së buxhetit të vendit në Kosovë kanë një rol të rëndësishëm ekonomik si dhe për mbajtjen dhe zhvillimin e një seri sektorësh të shoqërisë kosovare.

Politika Tatimore e një shteti është pjesë e politikës fiskale që lidhet me përcaktimin e llojeve të tatimeve të zbatuara në një vend, nivelet dhe llojet e përqindjeve tatimore për burimet e ndryshme të të ardhurave dhe raportin optimal ndërmjet tatimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta si dhe llojet e masat e lehtësimeve të ndryshme tatimore. Përveç funksionit të sigurimit të të ardhurave buxhetore, politika dhe sistemi tatimor i çdo vendi luan një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë pastaj në zhvillimin e arsimit; kulturës; shëndetësisë; punësimit dhe veçanërisht në rishpërndarjen e të ardhurave në favor të shtresave shoqërore me të ardhura më të ulëta të cilat në vendin tonë janë në një numër të konsiderueshëm. Sistemi dhe infrastruktura ligjore tatimore është kusht i domosdoshëm për arritjen e qëllimeve fiskale që do të thotë se ligjet e të gjitha llojeve të tatimeve duhet që të jenë të kuptueshme dhe lehtë të interpretueshme si për tatimpaguesit po ashtu edhe për zyrtarët tatimorë që merren me zbatimin e ligjeve tatimore në praktikë.²⁴

²⁴ Burimi: Ministria e Financave.

5. METODOLOGJIA

Për studimin e bërë rreth temës “Politikat Fiskale në Kosovë” më kanë ndihmuar materialet të huazuara nga web faqet e ndryshme si: Politikat fiskale në Kosovë, Buxheti i Republikës së Kosovës, Politika Tatimore në Kosovë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe materialet e huazuara nga shumë hulumtime të mëparshme, libra, publikime, si dhe statistikat që janë bërë ndër vite të buxhetit të Kosovës dhe shpenzimeve.

6. REZULTATET

Autoritetet e UNMIK-ut kanë bërë përpjekje serioze për themelimin e administratës tatimore dhe janë arritur rezultate të konsiderueshme në këtë drejtim sikurse edhe në aftësimin e stafit profesional. Mirëpo, vërehen mangësi të theksuara në dispozitat e Rregullores mbi tatimin në shërbime hoteliere dhe Rregullores mbi tatimin e paragjykuar. Mendojmë se me mënyrën e zbatimit të këtyre tatimeve për disa kategori të tatimpaguesve krijohen disavantazhe e disa të tjera janë të privileguara. Me dispozitat në fuqi të cilat rregullojnë caktimin dhe inkasimin e tatimit në shërbimet hoteliere parashihet se subjektet që nuk arrijnë brutoqarkullimin mujor deri në 15.000 DM lirohen nga tatimi sipas normës prej 10 % në bruto qarkullim, ndërsa tatimohen vetëm me shumën paushallë prej 400 DM. për një tremujor. Kjo metodë e tatimit, sipas Rregullores në fuqi, nuk është stimuluese por as nuk premtan efekte më të sigurta fiskale.

Një tjetër reformë do të mund të ishte rritja e TVSH-së (apo hapja e fluktimit të TVSH-së, p.sh 6-20 %) për disa produkte si dhe vendosja e një TVSH-je të përshkallëzuar që do të kishte një rol të rëndësishëm në ofrimin e mundësive të zhvillimit të kompanive kosovare. Pra, kompanitë do të mund të paguanin TVSH më të ulët për disa makineri prodhuese, makineri pune dhe për lëndë të parë. Nga ana tjetër TVSH-ja e rritur sigurisht që do ta vështirësonte pozitën e konsumatorit për disa nga produktet e konsumit të zgjatur (produktet e luksit) por që në të njëjtën kohë do ta zvogëlonte mundësinë e qasjes së produkteve nga importi në Kosovë me nivel fluksi të tanishëm. Kjo do ta stimulonte produktin vendor, i cili me këtë reformë tatimore do të dilte më i lirë në treg. Kjo rritje e TVSH-së për disa nga produktet gjithashtu do të mund t'i balanconte humbjet të cilat do të mund të shkaktoheshin me aplikimin e TVSH-së së përshkallëzuar.

Dhe krejt në fund, duhet theksuar se tanimë janë bërë disa përpjekje për lehtësime tatimore të cilat janë përfshirë në ligjin i cili liron nga tatimet disa nga sektorët dhe disa nga makineritë. Ky ligj mundëson lirime nga tatimet të produkteve të cilat përdoren për mirëqenie të përgjithshme si: automjete dhe makineri të cilat përdoren për raste urgjente, si dhe për raste të veçanta, pra që nuk përdoren shpesh, që kanë kosto të mëdha dhe nuk ofrojnë profit të madh (p.sh makina për ndërtim të urave të mëdha, të digave etj). Pra, në këtë ligj nuk hasim lirime për produktet të cilat do të mund të ndihmonin rritjen e kapacitetit prodhues të vendit për eksport.

7. DISKUTIME DHE PËRFUNDIME

Mungon strategjia dhe programi i një politike konzistente dhe stabile të taksave, përkatësisht fiskale në përgjithësi: Në bazë të rezultateve të inkasimit të obligimeve fiskale në vitin 2000 dhe sipas vlerësimeve të AQF, obliguesit tatimor i kanë pranuar instrumentet aktuale fiskale në mënyrë të kënaqëshme. Mirëpo, sipas rezultateve të Anketës së Riinvestit në 300 ndërmarrje private, mund të konstatojmë se komuniteti i biznesit normat tatimore dhe doganore i vlerëson të larta dhe të papërbalueshme. Ndërsa kur është fjala të instrumentet e reja fiskale që parashihen të aplikohen së shpejti komuniteti i biznesit ka kryesisht mendim pozitiv.

Për momentin ne jemi në fazën e ngritjes së administratës tatimore dhe të trajnimit të stafit të tij. Nuk duhet harruar se ky proces kërkon kohë andaj kërkohet gradualitet mes ballafaqimit me tatime komplekse. Struktura aktuale e instrumenteve fiskale bazohet vetëm në ngarkesat e biznesit kurse është e domosdoshme që sa më shpejtë që të jetë e mundur të fillohet me aplikohen instrumente fiskale që do të ngarkonin të ardhurat, pasurinë dhe fitimin e qytetarëve, mënyrë që arrihet shpërndarja më e drejtë e këtyre detyrimeve në favor të biznesit. Në këtë drejtim duhet të ndiqet përvoja e vendeve në tranzicion dhe vendeve të zhvilluara. Politikat aktuale tatimore në Kosovë janë mjaft të moderuara. TVSH-ja është 16 %, që e stimulon importin dhe është më e ulëta në rajon. Tatimet në të ardhura janë ‘progresive të moderuara’, gjë që më shumë i favorizon ata që kanë paga më të mëdha se sa ata me paga më të ulëta. Tatimet të cilat paguhet në kufi, si TVSH-ja, reinbursohet më pastaj nga vetë konsumatorët tek shitësit dhe prodhuesit.

Tani do të fokusohem me shqyrtimin e atyre tatimeve të cilat janë vendimtare në politika tregtare dhe fiskale. Tatimi prej 10 % në dogana - Lidhur me këtë kemi bërë një analizë gjysmë empirike, duke u nisur së pari nga fakti që të gjithë e dimë që aktualisht kemi 2.2 miliardë euro importe, duke abstrahuar këtu 47 % të tregtisë me vendet e CEFTA me të cilat nuk paguhet 10 % dogana, atëherë mbetet që për 1,13 miliard euro importe mblidhen 10 % të tatimit doganor, e nëse kësaj ia shtojmë të dhënat statistikore që diku rreth 20 % të këtyre importeve janë repromaterial, atëherë del se miliona euro do të duhej humbur nga buxheti i Kosovës në rast lirimi imediat të bizneseve nga këto tatime. Këtë sigurisht që vështirë do ta pranonte ndonjë shtet në rajon dhe në botë, pra që përnjëherë t’i shkaktojë vetës mungesa në buxhet me një sasi, sipas vlerësimit tonë,

prej rreth 5 deri në 10 %. Kjo do të shkaktonte mos-funksionimin e disa prej dikastereve të cilat edhe ashtu janë gjysmëfunksionale.

Pa dyshim se një reformë e politikave tatimore duhet bërë në kuptimin që së pari të caktohen sektorët prioritarë të ekonomisë dhe pastaj për këta sektorë të shfrytëzohen modelet e lirimit nga tatimet. Kjo do t'i zvogëlonte humbjet buxhetore të përnjëhershme dhe do t'i jepte mundësi zhvillimit të sektorëve të cilët kanë përparësi konkurruese me rajonin apo edhe më gjerë. Kjo do të thotë se këto kompani mund të prodhojnë për të eksportuar, e me këtë edhe do të ndikonin në zgjerimin e bazës ekonomike të Kosovës.

Është me rëndësi se të gjitha këto tatime do të mund të formuloheshin në atë mënyrë që do t'iu ndihmonin bizneseve të cilat kanë kapacitet zgjerimi. Mirëpo, kjo assesi nuk do të thotë se kompanitë më të dobëta do të duhet lënë anash. Për këto kompani Qeveria do të duhej krijuar fonde të veçanta nga suficiti i buxhetit me të cilat do t'i financonte ato me norma shumë të ulëta të interesit. Kjo do të krijonte një hapësirë të mirë që këto kompani, pasi të jenë treguar të suksesshme, të lirohen nga tatimet të cilat pengojnë në zhvillimin e tyre dhe në eksportim të produkteve të tyre.

8. BIBLIOGRAFIA / REFERENCAT

1. Mustafë Hasani, Politikat Fiskale, Prishtinë (2013) Ligjërues në Universitet për Biznes dhe Teknologji “UBT”.
1. http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Programi_i_Qeverise_shqip_.pdf
2. http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/PolitikaTregtare_Fin_270809.pdf
3. <http://mf.rks-gov.net/>
4. <http://www.telegrafi.com/ekonomi/politika-tatimore-ne-kosove-objektivat-dhe-rezultatet-e-saj-49-204.htm>
5. <http://www.riinvestinstitute.org/publikimet/pdf/30.pdf>
6. http://www.kipred.org/advCms/documents/1732_administrimi_dhe_qeverisja_ne_kosove_.pdf
7. <http://www.scribd.com/doc/16330729/Politika-Fiskale>
8. <http://levizjaperbashkim.com/new/informacion.php?id=413>